



Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i viktimave të trafikimit

Udhëzues Praktik



Tiranë, 2022



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Me mbështetjen financiare të Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SHBA në Tiranë. Opinonet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë te autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Ky Udhëzues për pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e viktimave të trafikimit u përgatit nga organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” (D&E), në kuadër të projektit: “Fuqizimi i të mbijetuarve të trafikimit për pjesëmarrje dhe përfaqësim në punën kundër trafikimit” me mbështetjen financiare të Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SHBA në Tiranë.

Autor:
Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”

Konsulente:
Valbona Lenja

Kontribues:
Mariana Meshi
Milaim Demnushaj
Lorela Dimo

Design & Layout:
Elzana Agolli

Ilustrim:
Grupi “GUXO”

© Shoqata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”, 2022

I. HYRJE

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i individëve viktimë trafikimi në përpjekjet anti-trafik është një praktikë e nxitur qysh herët prej organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë. Megjithëse është bërë pjesë integrale e praktikës së organizatës dhe bashkëpunëtorëve të saj, pjesëmarrja dhe përfaqësimi nuk ishin eksploruar ndonjëherë në mënyrë të strukturuar dhe eksperiencat për to nuk ishin ndarë ndonjëherë përveçse në mënyrë sporadike dhe në funksion të projekteve dhe aktiviteteve anti-trafik.

Projekti “Fuqizimi i të mbijetuarve të trafikimit për pjesëmarrje dhe përfaqësim në punën kundër trafikimit” mbështeti fokusimin në mënyrë të veçantë tek pjesëmarrja dhe përfaqësimi, si çështje të rëndësishme më vete.

Për këtë projekt u investua në formën e: vlerësimit të referencave dhe praktikave të mëparshme të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit; formimit të aftësive për pjesëmarrje dhe përfaqësim më të shtrirë dhe më të sigurt; mbështetjes së aktiviteteve ekskluzivisht të dizenuara dhe të zhvilluara nga viktimat.

Një vlerësim i zhvilluar në fillim të projektit shërbeu për të identifikuar përmbajtjen e këtij udhëzuesi, metodat e trajnimit dhe trajnuesit për të mbijetuarit e trafikimit dhe për anëtarët e MKR-së dhe modele të pjesëmarrjes së të mbijetuarve të trafikimit në punën anti-trafik.

Ky fokus i ri dhe kjo qasje e re e projektit prodhoi në mënyrë të natyrshme iniciativa të reja. Pjesëmarrësit ish viktimë të trafikimit ndjenë të nevojshme qysh në fillim të krijonin dhe të identifikoheshin si një grup - grupi “Guxo”, si edhe të hartonin një “Strategji Alternative Anti-trafik” me qëllime dhe aktivitete ekskluzivisht të tyre që mund të bëhet lehtësisht pjesë e planeve të aktorëve anti-trafik.

Ky udhëzues ndjek në përmbajtje dhe në formë aktivitetet dhe proceset e zhvilluara gjatë projektit dhe atyre që do të duhet të zhvillohen në të ardhmen për të siguruar qëndrueshmërinë e arritjeve të deritanishme dhe për të “vjelë produkte anti-trafik” të cilat duan kohë të kultivohen e të zhvillohen.

E fundit, ky udhëzues nuk tenton të kompensojë mungesat apo mangësitë në parashikimet ligjore lidhur me pjesëmarrjen dhe përfaqësimin. Përdoruesit e këtij udhëzuesi vetëm mund të zhvillojnë ide se si të rishikojnë me hollësi parashikimet ligjore mbi pjesëmarrjen dhe përfaqësimin për të ndërmarrë iniciativa për të plotësuar mungesat apo korrigjuar mangësitë.

II. SHKURTIMET E PËRDORUARA

AAGW	Albanian Association of Women and Girls /Shoqata Shqiptare e Grave dhe Vajzave
D&E	Different & Equal /Të Ndryshëm & Të Barabartë
KKSAT	Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Anti-Trafik
MB	Ministria e Brendshme
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetit
OKB	Organizata e Kombeve Të Bashkuara
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
SHS	Shërbimet Sociale
ZKKA	Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti-trafik

Tabela e lëndës

I. HYRJE	3
II. SHKURTIMET E PËRDORUARA	4
III. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI PJESEMARRJEN	6
IV. PJESEMARRJA NË PARANDALIMIN E TRAFIKIMIT	13
V. PJESEMARRJA NË MBROJTJEN E VIKTIMAVE	17
VI. PJESEMARRJA NË HETIMIN DHE DËNIMIN E TRAFIKANTËVE	26
VII. ANEKSE	29
VIII. REFERENCA	35

III. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI PJESËMARRJEN

Siguria në pjesëmarrje

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi duhet që në rradhë të parë të jenë të sigurt. **Është e rëndësishme** që profesionistët/ organizata:

- Të zhvillojnë dhe të përdorin mjete të matjes së rrezikut;
- Të ketë një protokoll pjesëmarrjeje të sigurt për aktivitetet që të ndiqet në mënyrë strikte;
- Të sigurojë transport të sigurt;
- Të ketë marrëveshje me ofrues sigurie për ndërhyrje në rast rreziku;
- Të ketë dhe të zbatohet në mënyrë strikte një protokoll për dokumentimin e pjesëmarrjes që të përcaktojë masat për mënjanimin e rrezikut p.sh. kush do t'i bëjë fotografimet, videot e bëra, kush do t'i përzgjedhë, t'i përpunojë etj..



Vullneti i lirë në pjesëmarrje

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi duhet të jetë me vullnet të lirë. Profesionistët duhet të mbajnë parasysh se shpesh, edhe pse nuk e shprehin, të mbijetuarit mund të ndjehen të detyruar të marrin pjesë në aktivitete sepse mund ta konsiderojnë këtë si një mënyrë të shprehjes së mirënjohjes së tyre për ndihmën e marrë. Vullneti për pjesëmarrje mund të shprehet me shkrim ose me gojë. Është e rëndësishme që vullneti i lirë për pjesëmarrje të ekzistojë përgjatë gjithë aktivitetit, dhe të mbijetuarit të kuptojnë se mund të tërhiqen në çdo kohë pa u ndier keq.



Ruajtja e konfidencialitetit në pjesëmarrje

Ruajtja e konfidencialitetit është një çështje sigurie por edhe etike. Është e rëndësishme që përpara se të vendoset për pjesëmarrje dhe përfaqësim të mbijeturave, të shqyrtohen të gjitha rreziqet e shkeljes së konfidencialitetit nga të gjitha palët dhe të bihet dakord për masat që do të merren për ruajtjen

e konfidencialitetit. Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” ka zhvilluar dhe përdor formate të vlerësimit të rrezikut gjatë marrjes pjesë në aktivitete të ndryshme.¹



Lehtësimi profesional i punës në grup të të mbijetuarve

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi është i lidhur ngushtësisht me lehtësimin e grupeve.² Profesionistët që lehtësojnë grupet duhet që të mbajnë parasysh që:

- Lehtësuesit duhet ta trajtojnë sigurinë dhe mirëqenien e të mbijetuarve si primare dhe shumëdimensionale, fizike, psikologjike, si dhe të vlerësuar rast pas rasti ;
- Lehtësuesit duhet të kenë njohuri për punën në grup, fazat e zhvillimit të grupit, dinamikat në grup;
- Lehtësuesit duhet të njohin shenjat/simptomat e traumës, efektet që kanë ngjarjet traumatike, shenjat e ritraumatizimit dhe duhet të marrin masa për të shmangur ritraumatizimin;



Koha e gjatë që kërkohet për pjesëmarrje

Sigurimi i pjesëmarrjes efektive të të mbijetuarve në punën anti-trafik është një ndërmarrje e cila kërkon kohë. Profesionistët duhet të jenë të gatshëm për të shpenzuar kohë për:

- informimin e qartë dhe të saktë lidhur me aktivitetet, rolet që individët do të kenë, rreziqet dhe pasojat pozitive dhe negative;
- akomodimin e orareve të punës, studimit, kujdesit për fëmijët;
- shërimin e traumave;
- përballimin e situatave të papritura sociale, shëndetësore, ekonomike.



Trajtimi i përshtatshëm në Media

Trajtimi i pjesëmarrjes nga media mund të ketë një efekt dëmtues jo vetëm mbi pjesëmarrjen por edhe mbi vetë mbrojtjen e përfituesve. Për të siguruar një mbështetje të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit nga media është e nevojshme

¹ Shih në Aneks I. Shembull -Vlerësimi i rreziqeve para përfshirjes

² Praktika pjesëmarrëse, zhvillimi i komunitetit dhe qasjet e bazuara në të drejtat shpesh punojnë me dhe përmes grupeve, duke kërkuar të ndryshojnë marrëdhëniet e pushtetit dhe duke u mundësuar pjesëmarrësve të marrin role udhëheqëse. Për më shumë , shih Our Voices Too Creating a safe space Ideas for the development of participatory group work to address sexual violence with young people , eveloped for the Our Voices Too Youth Advocacy , Project file:///C:/Users/user/Downloads/FINAL-UoB_OVToo_CreatingSafeSpaces_TOOLKIT_PAGES%20(1).pdf

që të punohet paraprakisht me median. Puna paraprake me pjesëmarrje të përfituesve duhet të përfshijë:

- Trajnimin e medias mbi etikën dhe sigurinë;
- Nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit për aktivitetet;
- Monitorimin e medias.



Barazia dhe mosdiskriminimi në pjesëmarrje

Njohja dhe zhvillimi i aftësive, si dhe talenteve të veçanta tek çdo individ është pjesë e procesit të fuqizimit. Megjithatë, në pjesëmarrje dhe përfaqësim kjo merr një rëndësi të veçantë.

Profesionistët duhet të kujdesen që të eksplorojnë aktivitetet që kanë potencial pjesëmarrjeje të lartë. Aktivitete të tilla janë fotografitë, sportet, teatri, kërcimi, protestat. Profesionistët duhet të bëjnë gjithashtu kujdes që talentet të mos konkurojnë me njëra tjetrën por të mbështesin njëri-tjetrin.

- *“Kemi nevojë për respekt dhe jo mëshirë”*

F. Anëtare e grupit “GUXO”



Mbështetja financiare për pjesëmarrje dhe përfaqësim

Sigurimi i pjesëmarrjes kërkon financim të veçantë. Profesionistët duhet të marrin në konsideratë dhe të mbështesin nevojat financiare që dalin gjatë pjesëmarrjes, të cilat mund të jenë shpenzime transporti, shpenzime për printime, fotokopje, etj., shpenzime për të ngrënë jashtë shtëpisë, veshje të përshtatshme për aktivitetet etj..

Nga ana tjetër, profesionistët duhet të konsiderojnë të mbijetuarit si ekspertë nga jeta,³ puna e të cilëve duhet të paguhet.



Komunikimi për Pjesëmarrje

Komunikimi është një nga kushtet kryesore për pjesëmarrjen. Profesionistët duhet të jenë të kujdesshëm sidomos të shmangin:

- Përdorimin e termit “viktimë”: Në shumë raste përdorimi i këtij termi pa përcaktorin “trafikimit, krimin” ngjall reagime negative sepse ka konotacionin negativ me të qenit “i/e paaftë mendërisht”;

³ Shih Small steps can make big difference

- Përdorimin e termit “rast” për t’iu referuar individëve prezentë;
- Krahasimin e individëve përfitues me njëri-tjetrin;
- Referimin vazhdimisht tek njëri individ si model sjellje apo komunikimi;
- Injorimin dhe mospërfshirjen në komunikim të individëve të cilët kanë vështirësi në komunikim.



Përgatitja për pjesëmarrje dhe përfaqësim

Ka tipare të personalitetit të cilat mund të vihen re dhe llogariten qysh në fillim të marrëdhënies me përfituesin. Ka të dhëna që për pjesëmarrjen p.sh. në jetën politike personaliteti konkurren me tipare demografike si edukimi, shtresa shoqërore, raca dhe të ardhurat.⁴ Tipare personaliteti të cilat duhen pikasur për pjesëmarrje janë: Ekstrovertizmi, të qenit mendjehapur (openness), dhe të rënit dakord (agreeableness). Personaliteti ekstrovert është një personalitet i cili mund të marrë pjesë dhe të përfaqësojë. Ai është tip shoqëror, thotë hapur mendimin dhe ruan emocione pozitive. Personalitetet mendjehapur janë edhe ata pjesëmarrës dhe përfaqësues të mirë sepse ata janë kuriozë, kanë imagjinatë, nuk konformohen dhe duan të çojnë përpara ide të reja. Personalitetet që “bien dakord” janë altruistë, të ngrohtë, bashkëpunues, mund t’u besosh. Këta njerëz mund të jenë të ndrojtur për të marrë pjesë dhe përfaqësuar dhe janë të prirur të tërhiqen kur ka debate, por janë një mbështetje e jashtëzakonshme dhe motivim për personalitetet ekstroverte dhe ata mendjehapur.

Megjithatë, janë njohuritë dhe konfidenca në njohuritë dhe aftësitë e veta ato që janë shtysat kryesore për pjesëmarrje dhe përfaqësim. Ndër njohuritë dhe aftësitë, ato që konsiderohen të rëndësishme për pjesëmarrje janë të drejtat e viktimave të trafikimit, vetëbesimi, të folurit në publik, njohuritë mbi trafikimin, dhunën me bazë gjinore, funksionimi i mekanizmit anti-trafik, njohuritë për funksionimin e institucioneve, etika e komunikimit. Në aktivitetet e trajnimit dhe informimit duhet patur parasysh që:

- Në një pjesë të përfituesve të shërbimeve njohuritë për funksionimin e institucioneve janë të kufizuara ndërsa në një pjesë tjetër mund të jenë edhe të keqkuptuara për shkak të eksperiencave që kanë patur;
- Trajnimi dhe informimi për të aftësuar të kërkuarin e të drejtave duhet të jetë praktik, me metoda pjesëmarrjeje. Është e rëndësishme që vetë përfituesit të vihen në role të lektorëve apo lehtësuesve të diskutimit;
- Gjatë trajnimeve të ruhet një nivel formaliteti në mënyrë që përfituesit të mësohen ta përballojnë në situata të tjera;

⁴ Caprara et al. 1999; Mondak & Halperin 2008; Ha et al. 2013; Fatke 2017; Weinschenk 2017, shih <https://onlinelibrary.wiley.com/doi/full/10.1111/1467-9477.12118>

- Nevojat për trajnim dhe informim duhen vlerësuar dhe plotësuar në mënyrë të vazhdueshme



Zgjerimi i funksioneve të pjesëmarrjes

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i individëve viktimë trafikimi në përpjekjet anti-trafik ka funksione të ndryshme. Vlerësimi që bëri D&E gjeti se funksionet e hasura më shpesh janë: funksionet e informimit për të përcaktuar shërbimet që do të merren; të dhënies së informacionit për situatën; të shprehjes së nevojës për ndihmë; të shprehjes së lëndimit, vuajtjes pasojave; të aplikimit të së drejtës për të vlerësuar shërbimet e marra dhe për t'u ankuar në rast se shërbimet nuk janë ato të duhurat.

Vlerësimi gjeti se temat/çështjet shqetësuese të mbrojtjes që duhet të zgjidhen me pjesëmarrje janë: mosdënimi i trafikantëve; mungesa e ndjeshmërisë dhe respektit nga ana e Policisë, Prokurorisë, Gjykatave dhe punonjësve të Institucioneve ndaj të mbijetuarve; mungesa e të kuptuarit të eksperiencave dhe emocioneve që përjetojnë nga të mbijetuarit; mungesa e trajtimit të barabartë pa diskriminim; mungesa e mbështetjes së plotë dhe cilësore psikologjike, mjekësore, ekonomike, ligjore, arsimore dhe sigurisë; mungesa e ndërgjegjësimit; mungesat në funksionimin e shkollës si mbrojtës i fëmijëve; mungesa e gazetarisë mbështetëse; mundësitë e punësimit.

Është e nevojshme që pjesëmarrja të shtrihet dhe forcohet edhe në funksione të tjera si: dhënies së një perspektive, këndvështrimi të ri alternativ të çështjeve anti-trafik; identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit;⁵ ngritjen e kapaciteteve të aktorëve anti-trafik etj.. Kontributi në ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve mund të përfshijë:

- Ndarjen me profesionistët të informacionit lidhur me mënyrat e rekrutimit, vendet e rekrutimit etj;
- Konsultimin e profesionistëve për përmirësimin e kushteve të identifikimit – hapësirat fizike të intervistimit, sjelljet e intervistuesve;
- Krijimin dhe vënien në dispozicion të profesionistëve të rrjeteve të informacionit mbi rreziqet apo referimet;
- Konsultimin e grupeve të lëvizshme të identifikimit.

5 Sipas një prej përfaqësuesve të autoriteteve të konsultuar për këtë Guidë “do të kishim pjesëmarrje të drejtpërdrejtë nëse të mbijetuarit do të ishin pjesë e rrjetit të parandalimit dhe identifikimit në varësi të ekspertizës”



Shmangia e roleve të parëndësishme, periferike

Pjesëmarrja mund të dëmtohet nga dhënia e roleve periferike, të parëndësishme. Shpesh, me arsyetimin se pjesëmarrja mund të krijojë probleme sigurie, profesionistët i japin të mbijetuarve role periferike, të parëndësishme në aktivitete. Kjo është veçanërisht shumë dëmtuese, sidomos kur pjesëmarrja ka qenë qendrore në fazat përgatitore të aktivitetit.



Mbështetja e krijimit dhe relatimi me grupet formale të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit

Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” e ka konsideruar organizatën “Albanian Association of Women and Girls” (AAGW) si një partner të rëndësishëm qysh në vitin 2004. Organizata ka kontribuar në krijimin e “Grupit Këshillimor të Viktimave” dhe po punon për zgjerimin e tij.

Sipas vlerësimit të zhvilluar, krijimi i “Grupit Këshillimor të Viktimave” duhet të ndiqet nga procese të krijimit të njësive të tjera të përbëra ekskluzivisht prej viktimave. Sipas vlerësimit, aktivitetet anti-trafik duhen rikonceptuar në mënyrë të tillë që viktimat të veprojnë dhe të relatohen si agjenci/ njësi më vete, por njëkohësisht njësi e tyre të bashkëveprojë, të integrohet dhe të ndërveprojë me institucionet e tjera.

Në përgjigje të kësaj gjetjeje, organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” mbështeti krijimin e grupit “Guxo”.

Në mbështetjen e krijimit dhe funksionimin e grupimeve të tjera duhet patur parasysh që:

- Të dedikohet kohë në krijimin e kohezionit të grupit;
- Të zhvillohet sa më herët një strategji zhvillimi dhe qëndrueshmërie;
- Të mbështetet grupi sa më shpejt që është e mundur me zhvillimin e projekteve dhe kërkimin e fondeve.

“Jemi ndjerë shumë mirë gjatë gjithë aktiviteteteve të projektit... kam folur për gjëra që ndoshta asnjëherë nuk kisha për ti thënë”.

A. Anëtare e grupit “GUXO”



Vetëvlerësimi prej shërbim ofruesve dhe vlerësimi i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm prej institucioneve monitoruese të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të sigurt që akomodon institucioni/agjencia

Ofruesit e shërbimeve mund t'u referohen parashikimeve ligjore për të zhvilluar dhe përdorur instrumente të veçantë të matjes së pjesëmarrjes dhe përfaqësimit. Instrumentat duhet të matin minimalisht: njohuritë që kanë përfituesit për shërbim-ofruesin dhe standardet e punës që duhet të zbatohen; punonjësit dhe funksionet e tyre; kohën e shpenzuar në takime/konsultime individuale apo në grup; dokumentacioni që përdoret; njohuritë për mënyrën si merren dhe ankimohen vendimet; qëndrimin e punonjësve ndaj grupeve dhe aleancave të përfituesve të krijuara etj..

IV. PJESËMARRJA NË PARANDALIMIN E TRAFIKIMIT



Konsiderata të përgjithshme lidhur me pjesëmarrjen dhe përfaqësimin në parandalim

Parandalimi është një nga fushat anti-trafik për të cilën të mbijetuarit e trafikimit artikulojnë më shumë.⁶ Në nxitjen e pjesëmarrjes në parandalim, profesionistët duhet të mbajnë parasysh që:

- Trafikimi konceptohet shpesh si i lidhur ngushtësisht me varfërinë dhe si i tillë i paevitueshëm;
- Parandalimi mund të kuptohet ngushtësisht si vetëm fushata ndërgjegjësimi;
- Parandalimi mund dhe duhet të targetojë edhe vetë të mbijetuarit e trafikimit si kategoria më vulnerabël;
- Parandalimi mund dhe duhet të përfshijë krijimin e komuniteteve të sigurta.

Modele të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në parandalim



Kërkimet dhe studimet prej të mbijetuarve

Kërkimet dhe studimet prej të mbijetuarve janë një formë e re kontributi që po mbështetet nga organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”

Në kuadrin e projektit “Hapat e vegjël mund të sjellin një ndryshim të madh”, një projekt studimi për veprim me pjesëmarrjen e të rinjve (YPAR), në bashkëpunim me Universitetin e Bedfordshire në Mbretërinë e Bashkuar, të mbijetuar të dhunës seksuale dhe trafikimit ndoqën një program trajnimi dhe zhvilluan një anketim për të mbledhur dëshmi mbi përvojat e të rinjve në drejtësinë penale për dhunën seksuale dhe trafikimin. Kjo iniciativë e mori shtypjen nga një projekt i mëparshëm, “OurVoices too” që evidentoi nevojën e dëshmive të informuara nga të rinjtë.

⁶ Gjetur edhe nga vlerësimi në kuadër të këtij projekti



Intervistat në media

Intervistat e të mbijetuarve në media janë sa të fuqishme në efekt aq edhe delikate dhe të vështira për t'u realizuar. Një dokument i hershëm i OBSH-së ka përcaktuar për herë të parë parimet etike dhe të sigurisë së intervistimit të të mbijetuarve gra nga gazetarët. Këto rregulla janë:

- Mos dëmto;
- Njihe të intervistuarin/të intervistuarën dhe vlerëso rreziqet;
- Përgatitu për referim;
- Zgjidh me kujdes përkthyesit dhe bashkëpunëtorët;
- Siguro anonimitet dhe konfidencialitet;
- Merr leje të informuar;
- Dëgjo dhe respekto vlerësimin që çdo grua i bën rreziqeve;
- Mos ritraumatizo;
- Përgatitu për ndërhyrje emergjente;
- Përdore informacionin për qëllime të mira.



Fushatat sensibilizuese

Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” ka mbështetur dizejimin e fushatave të ndërgjegjësimit prej të mbijetuarve.⁷ E tillë ishte fushata “Une jam SiTi! Une ja dola mbanë! Edhe ti mundesh!”. Kjo fushatë u mbështet fuqimisht nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti- trafik/ Ministria e Brendshme. Pjesë e fushatës ishin ekspozita me fotografi dhe poezi të krijuara nga vetë të mbijetuarit. Vetë ekspozita dhe albumi i krijuar mbi të tregonin trafikimin, shfrytëzimin, dhunën, abuzimin ashtu si ishin përjetuar prej të mbijetuarve. Pjesë e fushatës ishte krijimi dhe shfaqja e një videoje të shkurtër prej 30 minutash me fakte konkrete rreth shkallës së skllavërisë moderne, e cila u prezantua për një muaj në monitorët e disa linjave të autobusëve të qytetit të Tiranës.

Pjesë e fushatës ishte edhe instalacioni ndërgjegjësues “#UNËJAMSITI!” i realizuar dhe vendosur në ambientet e Parkut “Rinia” dhe më pas në ambientin e Drejtorisë së Policisë në Tiranës.

Brenda kornizës së “16 Ditëve Të Aktivizmit Kundër Dhunës Me Bazë Gjinore”, u realizuan një sërë aktivitete sensibilizuese të konceptuara nga të mbijetuarit e trafikimit anëtare të AAGW.

⁷ Shih për më shumë në <http://differentandequal.org/sq/mbeshtetja-e-viktimizeve-te-trafikimit-per-te-dizenjuar-dhe-zhvilluar-nje-fushate-ndergjegjesimi>



Rekomandime

- Fushatat duhet të përfshijnë një shumëllojshmëri mjeteve shprehjeje;
- Fushatat duhet të targetojnë një fashë të gjerë individësh dhe grupesh;
- Fushatat duhet të përfshijnë më shumë informacion për mënyrën se si funksionon trafikimi e trafikantët.



Llogaria ndërgjegjësuere në rrjetet sociale

Komunikimi i mesazheve nëpërmjet llogarive në rrjetet sociale është një metodë e rëndësishme për arsye se: Të gjitha organizatat apo grupimet, edhe nëse janë joformale, kanë një llogari në rrjetet sociale; Rrjetet sociale përbëjnë formën më të përhapur dhe më të shpejtë për të rinjtë; Platformat japin mundësi të ruajtjes së privatësisë dhe identitetit.



Rekomandime

- Kujdesu që llogaria të administrohet nga një person dhe përmbajtja e postimeve të ushqehet dhe rishikohet nga një panel i të mbijetuarve;
- Kujdesu që përmbajtja e postimeve duhet të ketë minimalisht: mënyrat se si përdoret një rrjet social; mënyrat e bllokimit të kërcënuesve; trajtimi i ftesave; mosndarja e adresave; menaxhimin e emocioneve të shkaktuara nga rrjetet sociale;
- Mos e ler pa mbështetje dhe pa konsultim personin që administron llogarinë.



Filmi

Pjesëmarrja nëpërmjet një filmi është një mënyrë e mirë për arsyet se: Është një mënyrë komunikimi e cila është e preferueshme nga të rinjtë dhe nga publiku në përgjithësi; Jep mundësinë e dhënies së shumë mesazheve njëherësh; Mund të modifikohet derisa të krijohet konfidenca që produkti takon pritjet; Mund të krijohet me mjetet në dispozicion dhe me aftësitë e zhvilluara teknologjike që kanë të mbijetuarit; Ka shumë të mbijetuar të cilët preferojnë të shkruajnë histori/ese dhe këto aftësi mund të zhvillohen deri në shkrimin e skenarëve të filmi.



Rekomandime

- Merr masa për ruajtjen e anonimatit;
- Mbështet skenare të bazuara në histori të vërteta;
- Jep mesazhe shprese.

V. PJESËMARRJA NË MBROJTJEN E VIKTIMAVE

Konsiderata të përgjithshme lidhur me pjesëmarrjen dhe përfaqësimin në mbrojtje

Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit, dhe në përgjithësi rritja e kontributit të viktimave në mbrojtje të viktimave e ka të domosdoshme njohjen dhe mirëpritjen e këtij kontributi nga institucionet dhe agjencitë që tradicionalisht ofrojnë mbrojtje. Ndërsa ofrimi i shërbimeve cilësore nuk mund të kuptohet pa përfshirjen dhe pjesëmarrjen në çdo moment të individit/përfituesit, institucionet dhe agjencitë mund të eksplorojnë mundësitë e tyre dhe të investojnë në:

- Vlerësimin e vazhdueshëm të nivelit të pjesëmarrjes së individit viktimë trafikimi në procesin e ndihmës;
- Ndërmarrjen e hapave konkretë për rritjen e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në dizejnimin e projekteve dhe politikave të mbrojtjes;
- Përcaktimin dhe zbatimin e masave penalizuese për mospjesëmarrje apo mospërfaqësim apo për shkelje të rregullave të sigurisë të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit;
- Vendosjen e një protokolli komunikimi/gjuhe të përdorur që nxit respektin dhe pjesëmarrjen;
- Rritjen e njohurive të viktimave mbi detyrimet institucionale të institucioneve;
- Aftësimin e viktimave për të marrë pjesë në procesin e identifikimit;
- Dokumentimin dhe ruajtjen e dokumentimit të mbrojtjes prej vetë të mbijetuarve/përfituesve;
- Identifikimin e burimeve të mbrojtjes dhe përditësimin e informacionit mbi to.

Modele të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në mbrojtje



Mentorimi

Mentorimi është një metodë efektive e pjesëmarrjes në mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Mentorët janë individë të cilët i kanë mbijetuar trafikimit, kanë marrë mbështetje riintegruese nga organizata e ndihmës dhe duan të mbështesin emocionalisht individë të tjerë (Të mentoruarit) . Mentorët zhvillojnë aftësitë e tyre mbështetëse nëpërmjet një programi trajnimi të veçantë të zhvilluar prej

organizatës. Mentorët takohen me individët që “mentorjnë” sipas një plani të caktuar zhvillimi. Gjatë takimeve ata mund thjesht të kalojnë kohë argëtuese së bashku, të shkojnë në një zyrë për një shërbim, të kërkojnë punë për të mentoruarin etj.. Mentorimi kryhet nën supervizionin e stafit të organizatës. Shtysat për përdorimin e kësaj forme pjesëmarrjeje janë të shumta: jep tek i mentoruari një ndjenjë të fortë pavarësimi; krijon ndjesinë që “mund t’ja dalësh”; i jep të mentoruarit një ndjenjë të fortë të të kuptuarit nga bashkëbiseduesi - mentori ka patur eksperiencë të ngjashme; jep mundësinë e të kuptuarit të dhënies së shërbimeve sipas kërkesave/ nevojave individuale.

“Sot jam duke u ndihmuar dhe ndihem shumë mirë... por dua që neser unë të kem mundësi të ndihmoj të tjera vajza që do të kenë nevojë”...

S. Anëtare e grupit “GUXO”

Në mënyrë që kjo formë mbështetje të funksionojë mirë duhet të mbahet parasysh në mënyrë të veçantë që:

- Të mentoruarit të informohen mirë për funksionet e mentorimit dhe rolin e Mentorit në raport me rolet e punonjësve të organizatës;
- Të shqyrtohet mirë situata e të mentoruarit dhe mentorit për të pasur përshtatje mes tyre;⁸



Rekomandime

- Mbani kontakte të vazhdueshme me Mentorin dhe të Mentoruarin për t’u dhënë mundësi të marrin udhëzime, të konsultohen për marrëdhëniet mes tyre, progresin etj.;
- Mos i ngarko Mentorit detyra të cilat nuk mund t’i kryejë;
- Mos i kërko Mentorit të bëjë pagesa, të japë borxh të Mentoruarit.

⁸ Për më shumë shih publikimin e “Të Ndryshëm & Të Barabartë” “Mentorimi i Viktimave të Trafikimit” në <http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2022/04/3.Mentorimi-i-Viktimave-Te-Trafikimit.pdf>



Pjesëmarrja në dizenjimin e projekteve të mbrojtjes

Pjesëmarrja në dizenjimin e projekteve të mbrojtjes ka efekte afatshkurtra dhe afatgjata mbi mbrojtjen. Në afat të shkurtër, kjo lloj pjesëmarrjeje krijon ndjenjën e të qenit të vlerësuar, jep mundësinë të kuptohet si funksionon ndihma dhe forcon marrëdhënien mes të mbijetuarve dhe punonjësve / profesionistëve të ndihmës. Në mbështetjen e kësaj lloj pjesëmarrjeje profesionistët duhet të kenë parasysh që:

- Të mbijetuarit nuk janë familjarë me thirrjet për projekte, mundësitë etj.;
- Të mbijetuarit nuk janë familjarë me mënyrën e funksionimit të sistemeve, të pritjeve të donatorëve etj.;
- Individët që po marrin ndihmë e kanë të vështirë të marrin pjesë në diskutime për dizenjimin e projekteve të ndihmës;
- Të mbijetuarit mund të kenë ndjenjë vetëvlerësimi të ulët.



Rekomandime

- Ndaj informacion sa më të plotë dhe të qartë lidhur me thirrjet për projekte, mundësitë etj.;
- Investo në përkthime, në prezantimin e funksionimit të sistemeve, të pritjeve të donatorëve etj.;
- Krijoni një atmosferë të sigurt të mirëpritjes, respektit dhe mbështetjes reciproke;
- Mos vendos afate të shkurtra e të shpejta për këtë lloj pjesëmarrjeje;
- Mos krijoni pritshmëri të gabuara.



Konsultimi i funksionimit të qendrave të akomodimit

“Të ndryshëm & Të Barabartë” e përdor konsultimin lidhur me funksionimin e qendrës si një metodë efektive të pjesëmarrjes dhe të kontributit të të mbijetuarve në mbrojtje.



Rekomandime

- Zhvilloni takime/konsultime të vazhdueshme;
- Përdorni metoda të ndryshme konsultimi dhe gjithëpërfshirëse;
- Jeni i hapur për ndryshime.



Vetëmbështetja nëpërmjet artit

Përveçse një mënyrë efikase ndërgjegjësimi, arti është një mënyrë efikase për vetë-mbështetje. Arti çliron stresin – redukton nivelin e kortizolit⁹, krijon një gjendje arritjeje dhe të ndjerit mirë me veten, i jep vlerë unikalitetit të individit, provon që ne mund të kthejmë një ide në një objekt fizik – që idetë mund të realizohen, ndihmon socializimin, ndihmon që të lesh gjërat të rrjedhin¹⁰.

Në nxitjen e vetëndihmës nëpërmjet artit, profesionistët duhet të marrin parasysh që:

- Individë të ndryshëm pëlqejnë forma të ndryshme arti: vizatimi, ngjyrosja, shkrimi, fotografia, gdhendja, instrumentat, vallëzimi, moda, puna me shtiza, krijimi i bizhuve;
- Individit mund të dojë edhe të shkatërrojë atë që ka krijuar si një mënyrë për të dëbuar fjalë, imazhe, ngjyra.



Rekomandime

- Të mbijetuarit duhet të kuptojnë që nuk kërkohet të jenë artistë;
- Nuk duhet kuptuar si klasë arti - të mbijetuarit nuk mësojnë teknika për të paraqitur botën e jashtme - ata lihen të shprehin botën e brendshme;
- Nuk është e nevojshme të ketë një vend strikt për aktivitetet;
- Terapia e artit nuk është efektive për të gjithë individët.



Kërcimi

Terapia e kërcimit / lëvizjes është një formë e arteve ekspresive që përdor lëvizjen e trupit për të shprehur emocionin dhe për të shëruar. Studime të ndryshme janë publikuar lidhur me përdorimin e kërcimit për çështje si: trauma, abuzim seksual, abuzim i fëmijëve¹¹. Mary Whitehouse, një pioniere e terapisë së kërcimit / lëvizjes ka zhvilluar parimin se që kërcimi / lëvizja, që të ketë efekt terapeutik parimi është vendosja e ndjenjave në lëvizje dhe jo thjesht krijimi i

9 Rritja e nivelit të kortizolit ose hormonit të stresit është e lidhur me ndjenjën e lodhjes, problemet e kujtesës, përqendrimit dhe të të nxënit, nervozizëm zemërim dhe agresivitet, dhimbje fizike - dhimbje koke ose stomaku, dobësim të sistemit imunitar dhe si pasojë sëmundje, alergji, etj..

10 <https://thewholeu.uw.edu/2022/04/11/art-for-self-care-and-mental-health/#:~:text=Because%20of%20these%20feel%2Dgood,and%20resilience%20in%20aging%20adults>

11 Shoqata Amerikane e terapisë së kërcimit/ përkthyer kërcimin/ terapisë së lëvizjes si " përdorim psikoterapik i lëvizjes si një proces i cili rrit integrimin emocional, cognitiv fizik dhe social të individit https://digitalcommons.lesley.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1286&context=expressive_theses

i një lëvizjeje që është e kënaqshme për syrin¹². Kërcimi është një mënyrë në të cilin mund të marrin pjesë një pjesë e madhe e të mbijetuarve.



Rekomandime

- Kujdesu që të ketë një individ me eksperiencë që mund të bëjë koreografinë;
- Kujdesu që të përzgjidhet një muzikë ekspresive, e cila të rezonojë me ndjenajt e të gjithë pjesëmarrësve.



Fushatat që targetojnë viktimat

Komunikimi në fushata është një metodë efikase për të marrë pjesë në mbrojtje. Kjo sepse komunikimi në fushata arrin një numër të madh dhe një spektër të gjerë të individëve në situata të ndryshme.

Nga 19 Prilli deri në 30 Korrik 2018, për herë të parë në Shqipëri, një grup vajzash, të mbijetuara të trafikimit, me mbështetjen e organizatës “Të ndryshëm & Të Barabartë” organizuan fushatën me sloganin: “Une jam SiTi! Une ja dola mbanë! Edhe ti mundesh!”. Fushata përfshinte një sërë aktivitete: Ekspozitë fotografike me të njëjtin titull si slogani i fushatës, “Photo voice” (historia e një viktimë trafikimi e transmetuar me foto), poster, album fotografish, poezi, etj..

Një tjetër shembull është fushata “#METY”. Kjo është një nismë që u realizua në kuadër të muajit Mars, muajit të Historisë së Grave. Përmbajtja e saj i dedikohet viktimave të dhunës, abuzimit seksual dhe trafikimit. Qëllimi kryesor ishte sensibilizimi i publikut dhe i vetë viktimave për të drejtat dhe mundësitë që iu ofrohen.

Në aplikimin e fushatave si metodë pjesëmarrjeje në mbrojtje, profesionistët duhet të mbajnë parasysh që :

- Fushata kërkon parapërgatitje të gjatë;
- Mund të ketë hezitime të pjesëmarrjes për shkak të problemeve të sigurisë;
- Duhet ti kushtohet vëmendje e veçantë përzgjedhjes së sloganeve;
- Duhet kërkuar prania e autoriteteteve në fushata.

12 https://digitalcommons.lesley.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1286&context=expressive_theses



Rekomandime

- Jep mesazhe shprese dhe besimi për një të ardhme më të mirë;
- Jep kontakte të ndihmës;
- Kujdesu që fushatat të reflektohen në rrjetet sociale;



Letrat e hapura drejtuar viktimave

Letrat e hapura të shkruara prej të mbijetuarve të trafikimit, për të mbijetuarit e trafikimit, janë krijime përmes të cilave ata mund të japin kurajo, këshilla, të nxisin vetëidentifikimin dhe marrjen e ndihmës, të tregojnë solidaritet, të largojnë vetminë.

Letrat e hapura mund të postohen në rrjetet sociale, në ekspozita, mund të përdoren si fletushka për shpërndarje etj..

Në mbështetjen e kësaj forme pjesëmarrje në mbrojtje profesionistët duhet të kenë parasysh që:

- Shumë prej të mbijetuarve kanë përgjithësisht vështirësi në shprehje;
- Letrat mund të përmbajnë shumë ndjesi personale dhe mund të tingëllojnë më shumë si vetëmbështetje sesa si kontribut për të tjerët.



Komunikimet në grup me punonjës të institucioneve të ndihmës

Komunikimet në grup të të mbijetuarve me përfaqësuesit e institucioneve janë një metodë e mirë kontributi tek mbrojtja. Nëpërmjet këtyre forumeve, përfaqësuesit e institucioneve kanë mundësi të kuptojnë më mirë kompleksitetin e nevojave dhe shqetësimet e të mbijetuarve, pengesat që mund të hasin në marrjen e shërbimeve, nevojat për thjeshtimin e procedurave etj..

“Të ndryshëm & Të barabartë” e ka përdorur herët këtë formë pjesëmarrjeje. Kështu, më 9 dhjetor 2020, u realizua një «workshop online» me temë “Dhuna me bazë gjinore në sytë e të mbijetuarve të dhunës dhe trafikimit”. Ky ishte një bashkëbisedim midis vetë viktimave të dhunës dhe trafikimit dhe përfaqësuesve të Institucionve, OJF-ve dhe agjencive të angazhuara për mbrojtjen e tyre.

- “Mendoj se kontributi ynë do ju shërbejë shumë institucioneve dhe organizatave që të përmirësojnë punën e tyre për mbrojtjen e viktimave të trafikimit”

E. Anëtare e grupit “GUXO”

Në forumet e diskutimeve me institucionet duhet mbajtur parasysh që:

- Të mbijetuarit të përgatiten për komunikimin me përfaqësuesit e institucioneve – përgatitja të konsistojë në eksplorimin e çështjeve që janë të rëndësishme;
- Vetë përfaqësuesit e institucioneve duhet të jenë të përgatitur për të ndarë informacion me të mbijetuarit.



Rekomandime

- Jep mesazhin e të qenit të hapur dhe që mirëpret edhe kritika;
- Mos jep premtime që nuk mund t’i mbash.



Letrat e hapura drejtuar institucioneve

Letrat e hapura për institucionet janë një formë tjetër përçimi të perspektivës së të mbijetuarve tek autoritetet dhe pjesëmarrje në ndihmë. Eshtë e efektshme si metodë sepse: jep mundësinë e reflektimit të vetë të mbijetuarve mbi situatën, shkaqet; ndërgjegjëson publikun për probleme që mund të mos i njohë.



Rekomandime

- Jep mbështetje në hartimin e letrave të hapura;
- Merr informacion mbi efektet e letrës dhe përcillja të mbijetuarve hartues.



Ndërgjegjësimi në zonat periferike

Ndërgjegjësimi prej të mbijetuarve në zonat periferike është një mënyrë e mirë për arsyet se: Pjesa më e madhe e viktimave janë në zona periferike; Zonat periferike mund të jenë arritur nga projektet e organizatave por organizatat nuk janë shumë të informuar se si funksionojnë zonat periferike.



Rekomandime

- Lëvizja mund të bëhet me transport publik për të mos rënë në sy;
- Në zonat periferike duhet vepruar me grupe të vogla;
- Grupet e ndërgjegjësimit duhet të pajisen me broshura;
- Grupi duhet të pajiset me kompjuter, projektor;
- Takimet duhet të përfshijnë sesione të shkëmbimit të opinionëve;
- Grupi duhet të ketë pritje në komunitet – pika kontakti që të bëjnë përgatitjet;
- Duhet mbledhur informacion për komunitetin, sidomos për sigurinë.



Takimet me Policinë

Takimet me policinë janë formë e mirë pjesëmarrjeje me ndikim tek mbrojtja për shkak se policia është zakonisht kontakti i parë që duhet të jetë identifikues, ndihmues dhe mbrojtjes për të mbijetuarit. Në nxitjen dhe mbështetjen e takimeve të viktimave me policinë, profesionistët duhet duhet të mbajnë parasysh që:

- Takimet me policinë mund të shoqërohen me frikë për shkak të eksperiencave të mëparshme;
- Punonjësit e policisë mund të mos kenë qëndrimin e duhur të ndjeshëm ndaj të mbijetuarve;
- Punonjësit e policisë mund të mos njohin rolin anti-trafik të të mbijetuarve dhe mund të paragjykojnë aftësitë e tyre për të kontribuar.



Rekomandime

- Merrni masa që takimi të mos ketë vetëm diskutime por të përfshijë mjete të tjera të komunikimit, fotografi , filma etj.;
- Merrni masa që të mbijetuarit të takohen jo vetëm me policinë anti-trafik por edhe me policinë e komisariateve, të cilët janë praktikisht në kontakt të parë;
- Merrni masa që takimi të përçojë minimalisht mesazhet se: policia duhet të jetë dëgjuese e mirë; policia duhet t'i besojë viktimave; policia nuk duhet t'u kundërvihet viktimave; policia duhet të respektojë të drejtat e viktimave.; Informohuni të mbijetuarit mbi detyrimet institucionale të policisë;
- Njihuni paraprakisht me temat dhe çështjet që të mbijetuarit duan të diskutojnë.



Protesta

Pjesëmarrja e të mbijetuarve në një protestë është një mënyrë e mirë për arsyet se: Të mbijetuarit mund të miksohen me stafin e organizatave dhe në këtë mënyrë të mos identifikohen; Ka efekt më të fortë se aktivitetet e veçara të ndërgjegjësimit; Tërheq vëmendjen e mediave; Nuk le shteg për zvogëlim të problemit nga autoritetet; Forcon ndjenjën e solidaritetit dhe të përkatësisë.



Rekomandime

- Kujdesu që protesta të jetë paqësore, jo e dhunshme;
- Kujdesu që protesta të zhvillohet para institucioneve;
- Kujdesu që protesta të jetë e mirëorganizuar;
- Kujdesu që protestatë japë mesazhe të qarta;
- Kujdesu që protestat të zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme;
- Kujdesu që të përgatiten me kujdes posterat, materialet;
- Kujdesu që të merret leje;
- Kujdesu që të njoftohen partnerët.

VI. Pjesëmarrja në hetimin dhe dënimin e trafikantëve



Konsiderata të përgjithshme lidhur me pjesëmarrjen dhe përfaqësimin në hetimin dhe dënimin e trafikantëve

Ndryshimet në legjislacion kanë sjellë një qëndrim të ri në rritjen e pjesëmarrjes së viktimave në hetimet dhe proceset penale ndaj trafikantëve.

Nga ana tjetër është mirë evidentuar që viktimat e trafikimit, të cilat mbështeten dhe mbrohen siç duhet, ka më shumë të ngjarë të raportojnë krimin e trafikimit dhe të kontribuojnë në hetime, duke identifikuar kriminelët dhe dëshmuar kundër tyre. Kjo pjesëmarrje dhe ky kontribut nis me identifikimin e viktimave si të tilla. Mosnjohja e viktimave jo thjesht humb pjesëmarrjen e tyre por krijon premise që gjithë sistemi të humbë mundësinë për prova e fakte kundër kriminelëve.

Në nxitjen dhe mbështetjen e pjesëmarrjes së të mbijetuarve në hetime dhe procese penale ndaj trafikantëve profesionistët duhet të mbajnë parasysh që:

- Të mbijetuarit e kanë shumë të vështirë t'u besojnë autoriteteve;
- Pjesëmarrja në proces penal mund të afektojë negativisht të gjithë familjen e viktimës;
- Të mbijetuarit nuk kanë informacion se si funksionon sistemi i drejtësisë;
- Të mbijetuarit mund të pranojnë statusin e dhënë pa e kuptuar se çfarë do të thotë viktimë dhe se çfarë do të thotë trafikim, si ka qenë marrëdhënia e vërtetë me trafikantin, cili është rreziku që i kanoset prej tij/saj etj.;
- Pjesëmarrja në hetime dhe procese penale mund të konkurrojë me mbështetjen dhe bile nganjëherë ndihma mund të kushtëzohet me pjesëmarrjen. Të mbijetuarit janë përballuar me situata si kjo: "ose bashkëpunoj ose nuk je viktimë";
- Sistemi i drejtësisë penale është ndërtuar kryesisht për të kontrolluar krimin dhe jo domosdoshmërisht për të mbështetur viktimat, si dhe mbetet i orientuar tek autorët e veprës penale.

Modele të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në hetimin dhe dënimin e trafikantëve



Kallëzimi, dhënia e dëshmive

Kallëzimi, dhënia e dëshmive është mënyra më e shprehur e pjesëmarrjes së të mbijetuarve në hetimin dhe dënimin e trafikantëve. Në trajtimin e kësaj forme të pjesëmarrjes, profesionistët duhet të mbajnë parasysh që:

- Hetimet mund të nisnin edhe kryesisht, pa pasur kallëzim;
- Të mbijetuarit mund të mos jenë të ndërgjegjshëm ose mund të mos dinë të artikulojnë dëmtimet psikologjike, fizike dhe financiare që u ka sjellë trafikimi;
- Të mbijetuarit mund të mos jenë të informuar për të drejtat që kanë për mbështetje, ndihmë ligjore dhe këshillim gjatë proceseve penale.



Rekomandime

- Informo çfarë do të thotë trafikim, cilat janë metodat që përdorin trafikantët;
- Informo mbi dëmtimet që shkakton trafikimi tek viktimat;
- Sigurohu që i mbijetuari / e mbijetuara merr mbështetjen psikologjike dhe shoqërore të nevojshme gjatë procesit penal;
- Sigurohu që i mbijetuari / e mbijetuara nuk po ndjehet i/e detyruar të vazhdojë pjesëmarrjen;
- Sigurohu që mbështetja dhe ndihma të vazhdojë edhe pas përfundimit të procesit penal.



Studimet lidhur me hetimin dhe dënimin e trafikantëve

Një tjetër mënyrë pjesëmarrje e praktikuar janë studimet lidhur me hetimin dhe dënimin e trafikantëve. Më sipër është përmendur anketimi për të mbledhur dëshmi mbi përvojat e të rinjve në drejtësinë penale për dhunën seksuale dhe trafikimin.

Gjatë këtij projekti Grupi "Guxo" filloi mbledhjen e opinionëve mbi dënimin e trafikantëve në ekspozita nëpërmjet një ankete të përgatitur prej tyre.



Rekomandime

- Të mbijetuarit duhen përgatitur dhe mbështetur në punën studimore prej profesionistëve ekspertë në studime me pjesëmarrje;
- Duhën marrë masa për ruajtjen e mirëqenies fizike dhe emocionale të të mbijetuarve të përfshirë në punën studimore;
- Të mbijetuarit duhet të mbështeten në raportimin e punës studimore në format që ndjehen komfort;
- Të mbijetuarit duhet të vendosin vetë për fokusin e punës studimore.

VII. ANEKSE

Shembull Vlerësimi i Rreziqeve para përfshirjes – përdorur në projektin “Our Voices too”

Vlerësimi i Rreziqeve dhe Nevojave	
Informacion i shkurtër (pa emra)	
Punonjësi që ka zhvilluar vlerësimin	
Inicialet e të riut	
Gjinia	
Etnia	
Mosha	
Aftësi Ndryshe	
Përfshirja me shërbimin (me agjencinë) arsyeja për identifikim	
Emri i punonjësit kyç	
Kohëqëndrimi i pritshëm në projekt	

Nevojat e shoqëruara me përfshirjen në projekt dhe si mund të plotësohen ato	
Detaje të preferencave të dhe kërkesave të komunikimit (shkrim lexim)	
A kërkohet përkthim i materialeve informuese për të rinjtë në një gjuhë tjetër?	
Kërkesa për transport ose ambiente pune/takimi	
Nevoja të mundshme që palë të treta të jenë të pranishëm në takim	
Gjera të tjera që skuadra duhet të ketë parasysh që të sigurojë pjesëmarrje të plotë e të sigurt të të rinjve	

Rreziqe të shoqëruara me pjesëmarrjen në projekt dhe si mund të menaxhohen këto rreziqe	
Potencial për stres emocional? Nëse po, si mund të mënjahen ato?	
Rreziku që dikush të zbulojë lidhur me pjesëmarrjen dhe si mund të çojë kjo në dëmtim potencial?	
Efekt negativ në marrëdhëniet me familjen?	
Efekt negativ në marrëdhëniet terapeutike?	
Interferencë me procese aktuale ligjore – PËRFSHIRJE NË “HETIME LIVE”	
Rreziqe specifike në ambientin e grupit ose për shkak të përbërjes së grupit?	
Gjë tjetër që skuadra duhet të dijë që të sigurojë ndërhyrje të ndjeshme?	

Konsiderata dhe kërkesa të tjera lidhur me lejen:	
A është vlerësuar i riu si i aftë për të dhënë leje të informuar nëse informacioni i është dhënë në formatin e përshtatshëm?	
A është e nevojshme leja e prindit / kujdestarit?	
A ka rreziqe të shoqëruara me kërkimin e lejes prej prindit / kujdestarit?	
Nëse është e nevojshme leja e prindit / kujdestarit, a mund ta lehtësojë punonjësi marrjen e kësaj lejeje?	
Gjërat praktike:	
A mund të bëjë punonjësi hapin e parë të qasjes tek i riu bazuar në informacionin që i riu ka për projektin?	
Mbështetja më pas:	
A është punonjësi i aftë/i duhuri për të dhënë mbështetje më pas?	

.....

A dëshiron punonjësi ta ndjekë të riun edhe pas sesioneve që të sigurohet që ai/ajo është mirë?	
A është e nevojshme ndonjë formë e mbështetjes dhe ndjekjes më pas dhe kush mund ta japë këte?	
Kërkesa apo shqetësime nga ana e punonjësit?	

Shembull deklarami i vendimit të informuar për pjesëmarrje:

INFORMACION PËR AKTIVITETET DHE KONFIRMIMI PËR ANGAZHIM NGA PËRFITUESIT NË PROJEKTIN “FUQIZIMI I TË MBIJETUARVE TË TRAFIKIMIT PËR PJESËMARRJE DHE PËRFAQËSIM NË PUNËN ANTI-TRAFIK”

Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” po zbaton projektin “Fuqizimi i të mbijetuarve të trafikimit për pjesëmarrje dhe përfaqësim në punën anti-trafik”, financuar nga Ambasada Amerikane në Shqipëri.

Projekti ka për qëllim të krijojë një mjedis të përshtatshëm për pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e sigurt të të mbijetuarve të trafikimit në punën anti-trafik dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat e trafikimit, si dhe për t’i sjellë viktimat e trafikimit në një rol aktiv dhe të dobishëm në mbrojtjen e të mbijetuarve të trafikimit.

Nëpërmjet zbatimit të projektit synohet që të përmirësohet puna me viktimat e trafikimit duke marrë në konsideratë nevojat e tyre. Grupi i të mbijetuarve të trafikimit, që do të jenë pjesë e projektit, do të angazhohen në aktivitete ku do tu jepet mundësia të shprehin mendimet e tyre për mënyrën se si e shohin vetë ato nevojën për përmirësim sidomos në ofrimin e shërbimeve, mënyrën e komunikimit me punënjësit e Institucioneve përgjegjëse, respektimin e dinjitetit dhe mosdiskriminimin e tyre. Projekti synon që shërbimet dhe mbrojtja për viktimat e trafikimit të jenë të organizuara në një formë që të jetë sa më e përshtatshme për viktimat duke marrë në konsideratë mendimin e tyre. Institucionet duhet të marrin në konsideratë mendimin e vetë viktimave dhe të mbijetuarve të trafikimit gjatë punës me ta në mënyrë sa më të thjeshtë dhe të pëlqyer prej tyre, me një komunikim të hapur dhe të lirshëm dhe me respekt të ndërsjelltë. Lufta kundër trafikimit mund të përmirësohet dhe shërbimet për viktimat do të jenë më cilësore nëse merret në konsideratë mendimi i tyre.

Projekti do të zhvillohet gjatë periudhës qershor 2021 – maj 2022. Gjatë zbatimit do të organizohen disa aktivitete edhe me përfshirjen e drejtëpërdrejtë të një grupi të mbijetuarash të trafikimit që janë pjesë e programit të riintegrit të Organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë”.

Aktivitetet në të cilat do të përfshihen edhe grupi të mbijetuarve të trafikimit janë:

- **Përgatitja e një udhëzuesi praktik për përfshirjen e të mbijetuarve të trafikimit në punën anti-trafik.** Drafti i udhëzuesit do të konsultohet paraprakisht edhe me të mbijetuarat e trafikimit me qëllim përfshirjen në këtë dokument të mendimeve, ideve dhe sugjerimeve të tyre. Udhëzuesi do të shërbejë si model pune për punënjësit e Institucioneve përgjegjëse por do t’ju japë mundësinë edhe vetë viktimave që të jenë më të informuara mënyrën se si ato mund të përfshihen në punën anti-trafik, të jenë më të qarta për shërbimet që përfitojnë dhe detyrimet e Institucioneve për t’ju shërbyer.
- **Organizimin e trajnimeve (4 ditë trajnimi) me tema të ndryshme për fuqizimin e grupit të të mbijetuarve të trafikimit, që do të jenë pjesë e projektit.** Trajnimet do të zhvillohen nga eksperti i zgjedhur dhe stafi i projektit. Metodologjia e zhvillimit të trajnimeve dhe modulet e trajnimit

(përmbajtja) do të konsultohet paraprakisht me grupin e të mbijetuarave të trafikimit. Trajnimet do të ndihmojnë edhe për të rritur aftësitë e të mbijetuarave për të marrë pjesë në aktivitete dhe për të shprehur lirshëm mendimin e tyre për çështjet që i shqetësojnë. Trajnimet do të përgatisin grupin e të mbijetuarave për të zhvilluar fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitete për parandalimin e trafikimit.

- **Program mentorimi për të mbijetuarit/at e tjerë të trafikimit.** Gjatë 6-mujorit të dytë të projektit do të organizohet një program mentorimi për të mbijetuarit e trafikimit me angazhimin e drejtpërdrejtë të grupit të të mbijetuarave të trajnuar, që do të luajnë rolin e mentorit për të mbijetuarat e tjera të trafikimit. Me mbështetjen e stafit të projektit, grupi i të mbijetuarave të trafikimit, pas përfundimit të trajnimit do të ndihmojnë të mbijetuarat e tjera të trafikimit për t'i mbështetur ato në përballimin e vështirësive dhe problemve që vijnë si pasojë e trafikimit. Duke dhënë shembullin e tyre të përballjes me vështirësitë do të shërbejnë si model dhe frymëzim për të mbijetuarat e tjera të trafikimit, si dhe do të rrisin besimin tek vetja se janë në gjendje të japin kontributin e tyre për të luftuar trafikimin, duke ndihmuar edhe të tjerët.
- **Aktivitete dhe fushata ndërgjegjësimi me përfshirjen e drejtpërdrejtë të të mbijetuarave.** Gjatë 3 muajve të fundit të zbatimit të projektit do të organizohen disa aktivitete ndërgjegjësimi me përfshirjen e drejtpërdrejtë të të mbijetuarave të trafikimit (grupit të trajnuar). Në këto aktivitete grupi i të mbijetuarave të përfshirë në projekt do të jenë vetë protagoniste në zhvillimin e aktiviteteve dhe me mbështetjen e stafit ato do të kenë mundësinë të sjellin idetë dhe sugjerimet e tyre për të ndikuar në përmirësimin e punës anti-trafik dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit. Me zërin e tyre, grupi i të mbijetuarave do të kenë mundësi të ndërgjegjësojnë të tjerët duke ndikuar në shoqëri për mënyrën se si duhet të angazhohemi të gjithë për të luftuar trafikimin dhe për të mbrojtur viktimat e trafikimit.

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në aktivitetet e projektit

Pasi jam informuar për projektin deklaroj se:

- Kam lexuar informacionin për projektin dhe stafi i projektit më ka shpjeguar aktivitetet që do të zhvillohen dhe rolin tim si pjesëmarrëse në këtë projekt.
- Unë e kuptoj qëllimin e projektit dhe jam shumë i/e kenaqur që do të jem pjesë e grupit që do të angazhohet për zhvillimin e aktiviteteve të parashikuara përgjatë periudhës së zhvillimit të projektit, deri në përfundim të tij. Unë gjithashtu e kuptoj që mund të tërhiqem nga projekti nëse nuk jam më i/e kenaqur për të marre pjesë.
- E kuptoj që nuk do të më kërkohet të jap ndonjë përvojë personale në lidhje me situatën që kam kaluar. Në të njëjtën kohë, e kuptoj që projekti do të fokusohet në problemet e trafikimit të personave dhe se do të diskutohen tema që mund të jenë shumë të ndjeshme për mua ose të tjerët në grup.

- Kam marrë parasysh dhe i kam diskutuar me menaxheren time dhe stafin e projektit të gjitha implikimet e pjesëmarrjes në këtë projekt. Gjithashtu jam e informuar për aktivitetet, sfidat, nevojat dhe përfitimet në lidhje me angazhimin tim në këtë projekt.
- Unë e di që mund të kontaktoj me menaxheren time nëse ndihem e mërzhitur ose kam nevojë për mbështetje në çdo moment gjatë zbatimit të projektit. Unë e kuptoj që stafi i projektit do të më mbështesë nëse do të kem nevojë gjatë përfshirjes time në aktivitetet e projektit.
- Unë e kuptoj që pranimi për të marrë pjesë në këtë projekt nuk do të ndikojë në shërbimet që marr nga organizata ose marrëdhëniet e mia me profesionistët që më ndihmojnë.
- Unë e kuptoj që, si pjesë e projektit, do të më kërkohet të marr pjesë në diskutime dhe do të më bëhen pyetje për të dhënë mendimin tim gjatë zhvillimit të aktiviteteve të projektit. Stafi i projektit dhe eksperti do të më shpjegojë dhe diskutojë me mua për pjesën e angazhimit, përfshirë edhe pjesëmarrjen në diskutime.
- Unë e kuptoj që nuk jam e detyruar të marr pjesë në diskutime, nëse nuk dua. Unë e di që nëse marr pjesë në diskutime, kjo do të thotë që jam dakord me përfshirjen time dhe jam e kënaqur që informacioni i dhënë nga unë të përdoret për qëllimet e projektit, duke respektuar detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit. Unë e kuptoj që mund të tërheq pëlqimin që ky informacion të përdoret në çdo kohë.
- Unë jam në dijeni se nënshkrimi i këtij dokumenti nuk më angazhon në asnjë lloj forme ligjore ose ndonjë mënyre tjetër, por është thjesht konfirmim për pjesëmarrje në aktivitetet e projektit, të cilat më ndihmojnë për rritjen e njohurive dhe aftësive të mia për të kontribuar dhe për të marrë pjesë në mënyrë aktive në parandalimin e fenomenit të trafikimit të personave, si dhe për të përmirësuar mbrojtjen e të mbijetuarve të trafikimit.

Emri Mbiemri: _____

Firma: _____

Data: _____

VIII. Referenca

- Different & Equal, Studim mbi çështjet e bashkëpunimit të viktimave të trafikimit me autoritetet e zbatimit të ligjit, https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/Studim_mbi_%C3%A7eshtjet_e_bashkepunimit_te_viktimave_te_trafikimit_me_autoritetet_e_zbatimit_te_ligjit.pdf
- Different & Equal, Mbështetja e viktimave të trafikimit për të dizenuar dhe zhvilluar një fushatë ndërgjegjësimi, <http://differentandequal.org/sq/mbeshtetja-e-viktimave-te-trafikimit-per-te-dizenjuar-dhe-zhvilluar-nje-fushate-ndergjegjesimi/>
- Different & Equal, Mentorimi i Viktimave të Trafikimit, <http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2022/04/3.Mentorimi-i-Viktimave-Te-Trafikimit.pdf>
- Nordic Political Science Association, 2018, A Participatory Personality? Examining the Influence of Personality Traits on Political Participation, <https://onlinelibrary.wiley.com/doi/epdf/10.1111/1467-9477.12118>
- United Nations Security Council, Resolution 2467 (2019) Adopted by the Security Council at its 8514th meeting, on 23 April 2019, <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N19/118/28/PDF/N1911828.pdf?OpenElement>
- University of Bedfordshire, Small steps can make a big difference (Albania), <https://www.beds.ac.uk/sylrc/current-programmes-and-projects/small-steps-can-make-a-big-difference-albania/>
- Vendim nr. 670, datë 10.11.2021 Për një shtesë në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda 2021–2025 dhe planin e veprimit 2021–2022” <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/VKM-nr-670-date-10.11.2021-Plani-Kombetar-Antitrafik-2021-2023.pdf>
- Warrington, Camille, Our Voices Too Creating a safe space Ideas for the development of participatory group work to address sexual violence with young people, [file:///C:/Users/user/Downloads/FINAUoB_OVToo_CreatingSafeSpaces_TOOLKIT_PAGES%20\(2\).pdf](file:///C:/Users/user/Downloads/FINAUoB_OVToo_CreatingSafeSpaces_TOOLKIT_PAGES%20(2).pdf)
- United Nations, Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power, <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/declaration-basic-principles-justice-victims-crime-and-abuse#:~:text=Victims%20should%20be%20treated%20with,harm%20that%20they%20have%20suffered.>

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Shoqata "Të ndryshëm & Të barabartë"

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i viktimave të trafikimit :
udhëzues praktik / Shoqata "Të ndryshëm & Të barabartë".

– Tiranë : Shoqata "Të ndryshëm & Të barabartë", 2022

f.36 ; 21x29.7 cm.

ISBN 978-9928-4718-4-0

1.Trafikimi i qenieve njerëzore 2.Viktima

3.Udhëzues, doracakë etj.

343.54 (035)



Different & Equal

Rr. Fortuzi, Godina 24, Kati 3, Hyrja nr. 4, Ap.4 Tirane

Tel. 00355 4 2221892

Email: contact@differentandequal.org